

UDHËZUES

Mbi mënyrën e plotësimit të Dokumenteve Certifikues për nxënësit e Shkollave të Arsimit Profesional '2016

Në përfundimi të çdo viti mësimor, drejtoritë e shkollave profesionale lëshojnë për nxënësit e tyre, sipas viteve të studimit, këto dokumentacione vlerësuese:

Viti I-rë	DËFTESË SHKOLLORE
Viti II-të	DËFTESË SHKOLLORE CERTIFIKATË PROFESIONALE e Nivelit të I-rë
Viti III-të	DËFTESË SHKOLLORE CERTIFIKATË PROFESIONALE e Nivelit të II-të
Viti IV-të	CERTIFIKATË E MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE CERTIFIKATË PROFESIONALE e Nivelit të III-të DIPLOMË E MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE PËRMBLEDHËSE e rezultateve të Praktikës së nxënësit

Për shumicën e dokumentacionit vlerësues, fletët parapërgatiten nga shtypshkronja në formate gjysmë të gatshme dhe janë drejtoritë e shkollave që bëjnë plotësimin e të dhënave për çdo nxënës.

Certifikatat Profesionale, Certifikata e Maturës Shtetërore Profesionale dhe Përmbledhëse e Rezultateve të Praktikës së nxënësit, janë dokumente që plotësohen me kompjuter (nëpërmjet skedarëve, përgatitur posaçërisht për këtë qëllim), ku sistemi përlllogarit automatikisht rezultatet individuale, etj.

Për përgatitjen e Dëftesave dhe Certifikatave përdoret letër e posaçme me elemente të personalizuar, (që në prodhimin e saj) nga fabrikat prodhuese.

Nëpërmjet këtyre masave dhe elementeve të tjerë shtesë grafike, synohet shmangia sa më shumë të jetë e mundur e përgatitjes së jashtëligjshme të dokumentacionit vlerësues të nxënësve.

Mënyra e plotësimit të Dokumenteve Certifikues

A. DËFTESA SHKOLLORE

Dëftesat shkollore, janë dokumente certifikuese që lëshohen për vitet e ndërmjetme, (klasa X, XI dhe XII) dhe qw plotësohet manualisht në formatet e parapërgatitura.

Llogaritja e treguesve bëhet sipas formulave:

- ✓ **Kreditit:** (Orë vjetore të Lëndës/Modulit/Praktikës) / (Nr. e javëve);
- ✓ **Numri i pikëve:** (Nota e vlerësimit) x (Nr. Krediteve) x (Koeficientin e Lëndës).

Shënim 1:

Në rastet kur nxënësit i nevojitet përdorimi i Dëftesat shkollore si dokument njohës certifikues jashtë shtetit, ajo nënshkruhet edhe nga Drejtuesi i Drejtorisë Arsimore Rajonale.

B. CERTIFIKATA PROFESIONALE e Niveleve

Certifikatat Profesionale, realizohet me kompjuter, duke përzgjedhur sipas Niveleve, skedarin përkatës të përgatitur në format *.doc¹.

Për plotësimin korrekt të emërtimit në anglisht të Drejtimit /Profilit mësimor, nevojitet që fillimisht të shkarkohet nga VET Portali², skedari i **Kompetencave Profesionale** të Drejtimit përkatës, përmbajtja e të cilit do të printohet detyrimisht edhe në faqen e pasme të Certifikatës Profesionale.

Printimi i këtij dokumenti realizohet mbi fletën e parapërgatitur nga shtypshkronja.

C. CERTIFIKATA E MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

Plotësimi i Certifikatës së Maturës Shtetërore Profesionale, bëhet me kompjuter nëpërmjet skedarit në format *.excel³, sipas kësaj radhe:

1. Shkruhet e plotë **Emri i shkollës** dhe **Qyteti** ku ndodhet ajo;
2. Duke klikuar, në shigjetën në anën e djathtë të fushës, (shfaqet shënimi me opsione) zgjidhet njëra nga mundësitë: **DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE** apo **ZYRA ARSIMORE**;
3. Plotësohet **Nr. i amzës** dhe **ID e Maturës**, (kjo e fundit plotësohet automatikisht në faqen e parë dhe të dytë!);
4. Shkruhet **Emri i nxënësit, Atësia, Mbiemri**, (automatikisht plotësohet në faqen e dytë!);
5. Plotësohen **lindur më në të rrethit**
6. Përzgjidhet duke klikuar në **Vitin shkollor** dhe në sistemin me kohë të **Plotë ose Pjeshme**;
7. Plotësojmë saktë **Drejtimin/Profilin** në të cilën është kualifikuar nxënësi (e dhëna plotësohet automatikisht në faqen e parë dhe të dytë!);

¹ Plotësim Certifikata Niveli I 2016

² <http://www.vet.al/oferts/qualificationlist>

³ Plotësim Certifikata Profesionale 2016

8. Plotësohen vetëm vlerësimet e **Provimeve të Detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale** dhe **Provimet me Zgjedhje të Maturës Shtetërore Profesionale**;
9. Pas plotësimit të rezultateve në faqen e dytë, automatikisht plotësohet edhe **Pikët mesatare për kredit**;
10. Pasi plotësohen drejtuesit e **DAR** dhe **Shkollës**, realizohet printimi (me formate të parapërgatitura) duke klikuar e përzgjedhur tek fusha e pozicioneve **Print_Arie** dhe **Print**, (këto të dhëna plotësohet automatikisht në faqen e parë dhe të dytë!);
11. Mjafton që në Faqen e dytë, të vendosen vetëm **Notat** dhe **Kreditet**, pasi sistemi do të shkruaj me fjalë ato dhe do të llogarisë automatikisht sipas formulave treguesit e tjerë, (**Pikët, Shumat, Mesataret** dhe **Pikët mesatare për kredit**);
12. E njëjta procedurë do të përdoret për printimin e faqes, klikojmë dhe përzgjedhim **Print_Arie** tek fusha e pozicioneve dhe **Print**, (**Kujdes** pasi të vendosni siç duhet fletën e printuar të faqes së parë!).

D. PËRMBLEDHËSE e rezultateve të Praktikës së nxënësit

Është dokumenti me të cilën pajisen nxënësit, vetëm në përfundim të plotë të studimeve 4 vjeçare.

Ai plotësohet nëpërmjet modelit të përgatitur në formatin *.excel⁴, sipas kësaj radhe:

1. Shkruajmë të gjitha emërtesat e Moduleve, Projektet e të nxënës, Praktikën profesionale, që nxënësi ka realizuar në programin mësimor gjatë katër viteve të studimit;
2. Plotësojmë vlerësimet e **Notave** me numra (sistemi shkruan automatikisht ata me germa!) dhe **Kreditet** e rezultateve të Praktikës;
3. Në fund të faqes, plotësohet edhe Tabela me rezultatet e **PROVIMEVE PËRFUNDIMTARE** dhe sistemi përlllogarit automatikisht **Shumat** dhe **Mesataret** përkatëse.
4. E njëjta procedurë përsëritet për printimin e faqes, pra, duke klikuar tek fusha e pozicioneve, përzgjedhim **Print_Arie** dhe pastaj **Print**.

Shënim 2:

Përpara përfundimit të vitit shkollor, drejtuesit e shkollave do tu vihen në dispozicion, jo vetëm formularit e parapërgatitura në shtyp por edhe skedarët përkatës, të nevojshëm për pajisjen e nxënësve të Shkollave Profesionale me dokumente certifikues për '2016.

Mars '2016

⁴ Plotesim Përmbledhëse e rezultateve të Praktikës së nxënësit 2016

